

Raportet e Shtetit mbi terrorizmin për vitin 2020:

KOSOVA

Vështrim i përgjithshëm: Kosova vazhdoi ta luftojë kërcënimin e terrorizmit përmes bashkëpunimit të ngushtë me Shtetet e Bashkuara. Kosova është anëtare e Koalicionit Global për mposhtjen e ISIS-it. Qeveria e Kosovës është duke hartuar një strategji të re të kombinuar dhe një plan veprimi kundër Terrorizmit (CT) dhe Kundërvënies së Ekstremizmit të Dhunshëm (CVE) deri në vitin 2025. Zyra e Koordinatorit për CT/CVE u shfuqizua në shkurt. Megjithatë, në korrik, Qeveria e re Hoti e emëroi Ministrin e Punëve të Brendshme, Agim Veliu, si koordinator kombëtar për CT/CVE.

Kosova vazhdon t'i adresojë pasojat e riatdhesimit në vitin 2019 të katër luftëtarëve të huaj terroristë (LHT) të dyshuar dhe 106 anëtarëve të familjeve nga Siria, një nga riatdhesimet më të mëdha civile deri më tani nga zona e konfliktit. Të gjithë të rriturit janë ndjekur penalisht ose janë gjykuar nga forcat e rendit dhe dy nga LHT-të meshkuj janë në burg. Gratë dhe fëmijët vazhdojnë të marrin ndihmë për riintegrim përmes programeve të financuara nga SHBA-ja dhe Evropa dhe Divizionit për Parandalim dhe Riintegrim të Ministrisë së Punëve të Brendshme (DPR). DPR-ja dhe Ministria e Arsimit u ndihmuan 37 nga 74 fëmijët e kthyer për t'u regjistruar në shkollë dhe, me ndihmën e donatorëve ndërkombëtarë, po i ndihmon gratë e kthyer për riintegrim dhe punësim.

Incidentet terroriste në vitin 2020: Nuk ka pasur incidente terroriste të raportuara në Kosovë në vitin 2020.

Legjislacioni, zbatimi i ligjit dhe siguria kufitare: Korniza legjislative e Kosovës është ndër më të prirurat në Ballkan për ndjekjen penale të individëve të dyshuar për kryerje ose mbështetje të aktiviteteve terroriste, por dënimet e shkurtra, lirimi i hershëm nga burgu dhe mungesa e mbikëqyrjes së organizuar pas lirimimit ngrenë pyetje për sigurinë afatgjate. Kosova e mbështet zbatimin e Rezolutës 2396 të KSKB-së për t'i luftuar udhëtimet terroriste dhe është duke punuar për ta zbatuar atë në praktikë; zotimet e 4 shtatorit në Uashington, të nënshkuara në Shtëpinë e Bardhë, e kodifikuan zotimin e Prishtinës për ta rritur sigurinë kufitare dhe kontrollin për ta ndaluar udhëtimin e terroristëve, përfshirë përmes ndihmës dhe partneritetit të ofruar nga SHBA-ja. Kosova e ka cilësuar tërë Hizbollahun si organizatë terroriste.

Agjencia e Bashkimit Evropian për Bashkëpunim në Zbatimin e Ligjit (EUROPOL) ka lidhur një marrëveshje zyrtare me Policinë e Kosovës në korrik. Emërimi i një ndërlidhësi të Policisë së Kosovës në EUROPOL dhe një marrëveshje për komunikime të sigurt planifikohen në të ardhmen e afërt. Kosova mbetet e përjashtuar nga anëtarësimi në INTERPOL, pjesërisht për shkak të kundërshtimit të Serbisë, që buron nga mungesa e marrëdhënieve të normalizuara.

Përmes pjesëmarrjes në programin e Departamentit të Shtetit për Asistencë kundër Terrorizmit, Policia e Kosovës – dhe posaçërisht Departamenti kundër Terrorizmit – janë trajnuar në hetimet kundër terrorizmit, për identifikimin dhe konfiskimin e provave digjitale, dhe kanë marrë grante për pajisje. Mentorimet e SHBA-së kanë arritur ta rrisin bashkëpunimin dhe ndarjen e informacionit ndërmjet Policisë së Kosovës dhe Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Më 11 dhjetor, Gjykata Themelore e Prishtinës i liroi të gjithë të pandehurit e përfshirë në rastin “Uragani” nga akuzat e lidhura me terrorizmin. Kjo është hera e dytë që të pandehurit shpallen të pafajshëm nga akuzat për terrorizëm, ndonëse ata u dënuan për posedim dhe tregti të

paligjshme të armëve. Ky rast së pari u padit në vitin 2015 nga prokurorët ndërkombëtarë dhe më pas iu kaloi sistemit gjyqësor vendor, duke qëndruar në gjykatat e Kosovës për pesë vjet.

Më 30 tetor, FTFja i dënuar, Agon Misini, u lirua nga burgu pasi vuajti 18 muaj nga dënimi i tij katërvjeçar për pjesëmarrje në një grup terrorist (ISIS). Misini ishte FTF-ja i parë i riadhesuar i dënuar në vitin 2019; megjithatë, Gjykata e Apelit ia llogariti kohën e kaluar në paraburgim në Siri pas arrestimit të tij në vitin 2017 nga Forcat Demokratike Siriane.

Më 20 tetor, Departamenti kundër Terrorizmit i Policisë së Kosovës e arrestoi një person që e kërcënoi Ambasadorin e Kosovës në Francë, pas ripostimit të ambasadorit në Tweeter të një artikulli të *Le Figaro* që e jepte një kronologji të sulmeve ndaj revistës satirike *Charlie Hebdo*. Prokurorët hapën një aktakuzë për nxitje për të kryer terrorizëm më 8 dhjetor.

Më 30 shtator, prokurorët e paditën Igballe Hudutin për nxitje për të kryer akte terroriste. Huduti u arrestua më 7 janar për postimet e saj në rrjetet sociale ku e kritikonte Uashingtonin për vrasjen e komandantit iranian Qasim Soleimani dhe bënte thirrje për hakmarrje.

Më 24 shtator, Gjykata Supreme e Kosovës e mbështeti dënimin me pesë vjet e gjysmë burg për pjesëmarrjen e Visar Qukovcit në një grup terrorist (ISIS), ndërsa urdhëroi një rigjykim për akuzat për abuzim të fëmijëve. Qukovci, një nga FTF-të e riadhesuar nga Siria në vitin 2019, kishte filmuar video propagandistike në të cilat ia vendoste një jelek vetëvrasës djalit të tij 3-vjeçar.

Më 10 janar, FTF-ja Arian Kryeziu u dënua me 46 muaj burg për pjesëmarrje në një grup terrorist (ISIS).

Prej 32 grave të riadhesuara nga Siria në vitin 2019, 29 u deklaruan fajtores për pjesëmarrje në ISIS dhe morën dënime të shkurtra me kusht. Gratë nuk do ta vuajnë dënimin me burg nëse nuk kryejnë krime të tjera, nëse rregullisht lajmërohen në Policinë e Kosovës dhe nëse shkojnë në psikoterapi. Që nga nëntori, shtatë gra të tjera janë paditur për pjesëmarrje në ISIS.

Kundërvënia financimit të terrorizmit: Njësia për Inteligjencë Financiare e Kosovës (NJIF) është anëtare e Grupit Egmont. Kosova ka hartuar një kornizë ligjore për sanksionet financiare të synuara kundër organizatave terroriste, e cila, pas miratimit nga Kuvendi i Kosovës, do t'i përmirësojë mjetet në dispozicion të NJF-së-së për ta kufizuar financimin e terrorizmit.

Kundërvënia ekstremizmit të dhunshëm: Strategjia e mëparshme CVE e Kosovës, një udhërrëfyes pesëvjeçar për frenimin e kërcënimit në rritje të terrorizmit përmes një qasjeje të tërë qeverisë, e theksoi rolin vendimtar të palëve të interesuara lokale dhe të shoqërisë civile. Zbatimi ka qenë i pabarabartë në ministritë e qeverisë dhe sfidat vazhdojnë për shkak të mungesës së kapaciteteve, burimeve të pamjaftueshme dhe një qasjeje tejet të konsoliduar ndaj CVE-së. Një grup punues ndërministror është duke hartuar një strategji të re dhe plan veprimi, i cili synon t'i bashkojë CT-në dhe CVE-në në një strategji të unifikuar; qeveria pret ta zbulojë këtë strategji në vitin 2021.

Shërbimi Korrektues i Kosovës — i ndihmuar nga ekspertët e SHBA-së — vazhdoi ta zbatojë një program për ta përmirësuar menaxhimin e terroristëve në burg. Ky program përfshin mbledhjen, analizimin dhe ndarjen e informacionit të burgut ndërmjet vendimmarrësve të shërbimit korrektues dhe organeve të tjera përkatëse për zbatimin e ligjit, dhe menaxhimin e rehabilitimit dhe riintegrimin eventual të terroristëve të dënuar. DPR-ja vazhdoi të zbatojë

programe për riintegrimin e individëve që e kanë vuajtur dënimin me burg nën akuzat për terrorizëm, FTF-të e kthyer dhe anëtarët e familjeve, ndërkohë që ka mungesë të vazhdueshme të stafit dhe të financave.

Kosova vazhdon aktivitetet bashkëpunuese përmes GCERF-së, një fond global publiko-privat për t'i mbështetur përpjekjet lokale, bazike kundër radikalizimit dhe rekrutimit në komunitetet në rrezik. Trembëdhjetë komuna të Kosovës janë anëtare të Rrjetit të Qyteteve të Forta.

Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe rajonal: Qeveria e Kosovës punon ngushtë me zyrtarët në Shqipëri dhe Maqedoni të Veriut për ta mbështetur ndërtimin e kapaciteteve kundër terrorizmit dhe bashkëpunimin rajonal.